

PRAKTIKA TË MIRA PËR TË NXËNËT NË KLASË NGA MËSUESIT E EKIPIT LËNDOR TË SHKENCAVE

1.METODA “MINITEST”

Në orën mësimore të lëndës së Matematikës, klasa VII-B me temë mësimore “Ushtrime për përforsim” dhe me koncepte kryesore zgjidhja e saktë e ekuacioneve dhe zbatimi i njohurive në problema , metoda e parashikuar në planin e orës mësimore “minitest’ më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Në këtë metodë u mundësua pjesëmarrja e të gjithë nxënësve dhe marrja e informacionit nga secili prej tyre. U panë mangësitë në secilin prej tyre.
- Pasi minitesti përfundoi, i diskutuam zgjidhjet e ushtrimeve të të dy grupeve.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin metodën ‘Minitest’, sepse ajo mundëson:

- Angazhimin e të gjithë nxënësve
- Zhvillim të menduarit kritik
- Nxitjen e krijimtarisë dhe zgjidhjeve të sakta të ushtrimeve dhe problemeve
- Reflektim mbi gabimet e mundshme

Mësuesja: Ermonela Harizi ermonela.harizi@gea.edu.al

2. METODA “DORA E FSHEHTË”

Në orën mësimore të lëndës Biologji, klasa VIII-B me temë mësimore ‘Zemra’ dhe me koncept kryesor ndërtimi anatomik i zemrës, metoda “dora e fshehtë”, e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Krijohen grupe të nxënësve, ku numri i anëtarëve të një grupi nxënësish përputhet me copëzat e një teksti të ndarë nga ana ime. Secili nxënës përgjigjet për përmbajtjen e pjesës së tij dhe në fund bëhet renditja e copëzave, e shoqëruar me pyetje dhe diskutime
- I jap secilit nxënës nga një tekst në të cilin është shkruar një paragraf i shkurtër. Secili nxënës lexon pjesën e vet të tekstit dhe nxënësit e tjerë mund të bëjnë pyetje.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën ‘Dora e fshehtë’ sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë me anë të angazhimit maksimal të nxënësve dhe nxit të menduarit kritik.

Mësuesja: Klesja Mukaj klesja.mukaj@gea.edu.al

3. METODAT "PUNË NË GRUPE" DHE "EKSPERIMENT" PËR DUKURITË ELEKTROSTATIKE

Në orën mësimore të lëndës Fizikë, klasa 9-A, me temë mësimore ‘Dukuri Elektrostatiqe’ dhe me koncept kryesor Ngarkesa Elektrike, Tensioni Elektrostatiq dhe Fushat Elektrostatiqe,

metodat e parashikuara në planin e orës mësimore, si "Punë në grupe" dhe "Eksperiment", mundësuan një përfshirje aktive të të gjithë nxënësve dhe rritjen e angazhimit të tyre në mësim. Këto metoda u përdorën për të zbuluar dhe eksperimentuar për dukuritë elektrostاتيke. Metodat u zbatua në këtë mënyrë:

- Mësuesja organizoi klasën në 3 grupe, secili grup me nga 6-7 nxënës. Për secilin grup u caktuan detyra dhe pozita për çdo anëtar, si: Drejtues grupi, regjistruues, dhe eksperimentues. Secili grup u pajis me materialet e nevojshme për eksperimentet: shkopinj plastik, topa të vegjël me ngarkesë, furça për ngarkimin e trupave, dhe instrumente të thjeshta për matjen e tensioneve elektrostاتيke, si voltmetra dhe elektroskopë.
- Secili grup do të realizonte një eksperiment të ndryshëm për të demonstruar një dukuri elektrostاتيke. Grupi i parë do të eksperimentonte me ngarkimin e trupave me fërkim, grupi i dytë me veprimin e forcës elektrostاتيke mes dy trupave të ngarkuar dhe grupi i tretë do të matte tensionin elektrostاتيک në një fushë elektrostاتيke.
- Eksperimentet e caktuara për grupet:
 - Grupi i parë: Ata përdorën një shkop plastik dhe një top të vogël për të krijuar ngarkesë përmes fërkimit dhe për të vëzhguar tërheqjen dhe dëbimin e trupave të ngarkuar. Ata do të regjistronin çdo ndryshim në forcën që ushtronin trupat e ngarkuar mbi njëri-tjetrin.
 - Grupi i dytë: Ky grup do të përdorte dy topa të ngarkuar për të eksperimentuar me forcën elektrostاتيke që ndodhte kur ata i afronin dhe largonin njëri-tjetrin. Nxënësit do të regjistronin se si ndryshonte forca kur largoheshin ose afroheshin më shumë.
 - Grupi i tretë: Ky grup do të matte tensionin elektrostاتيک që krijohet në një fushë elektrostاتيke mes dy ngarkesash të ngjashme dhe të kundërta dhe do të përdornin voltmetrën për të regjistruar vlerat e tensioneve që krijoheshin.
- Secili grup kishte 10 minuta për të realizuar eksperimentin dhe për të mbledhur të dhënat. Gjatë kësaj periudhe, unë si mësuese kam monitoruar përparimin e grupit, kam ndërhyrë për të sqaruar dyshimet dhe kam ofruar asistencë për zgjidhjen e problemeve që mund të kishin nxënësit.
- Pas realizimit të eksperimentit, secili grup ka pasur 5 minuta për të prezantuar rezultatet e punës së tij dhe për të diskutuar në lidhje me dukuritë që vëzhguan gjatë eksperimentit. Ata kanë diskutuar për ngarkesën elektrostاتيke, forcën e elektrostاتيکës dhe ndikimin e fushës elektrostاتيke në mjedisin rrethues. Gjatë prezantimit, grupet kanë ndarë vëzhgimet dhe përfundimet që kanë arritur, duke përdorur materiale të krijuara në grup dhe duke diskutuar përshkrimin e dukurive elektrostاتيke.

Nxënësit kanë kuptuar thelbin e dukurive elektrostاتيke, përmes eksperimenteve praktike, dhe kanë mundur të lidhen teorinë me praktikën. Ata janë angazhuar aktivisht dhe kanë arritur të përvetësojnë njohuri të reja mbi fenomenet elektrostاتيke.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që të përdorin sa më shpesh metodat "Punë në grupe" dhe "Eksperiment" pasi ato stimulojnë bashkëpunimin dhe zhvillimin e aftësive praktike të nxënësve. Kjo metodë është e veçantë për zhvillimin e mendimit kritik dhe për rritjen e angazhimit në klasë.

Mësuesja: Suela Dema

suela.dema@gea.edu.al

4.METODA “PUNË NË GRUPE”

Gjatë orës mësimore të lëndës së biologjisë, klasa XI, me temë mësimore “Ushtrime mbi trashëgiminë e grupeve të gjakut”, metoda “punë me grupe” e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në procesin mesimor. Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Nxënësit u ndanë në grupe pune prej katër vetësh. Secili grup përbëhej nga nxënës të niveleve të ndryshme.
- Grupet u pajisen me tre ushtrime të niveleve të ndryshme të vështirësisë.
- Në përfundim të ushtrimit të parë, nga secili grup doli një përfaqësues që e zhvilloi ushtrimin në tabelë. Gjatë zhvillimit të metodës pati diskutime mes grupeve.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin metodën ‘Pune ne grupe’, sepse ajo mundëson angazhimin e të gjithë nxënësve, zhvillim tek ata të aftësive bashkepunuese duke nxënë nga njëri tjetri, por dhe rritje të vetëbesimit të tyre.

Mësuesja: Irida Rapia

irida.rapia@gea.edu.al

5.METODA “PUNË E PAVARUR”

Në orën mësimore të lëndës TIK 12 me zgjedhje, klasa XII-A me temë mësimore “Hyrje në bazën e të dhënave.” dhe me koncepte kryesore “Administrimit të bazës së të dhënave” , metoda ‘Punë e pavarur’, e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- U organizua një bisedë e shkurtër me të gjithë klasën, për përforcimin e dijeve, duke përdorur teknikën “Rishqyrto idetë kryesore”.
- U zhvillua veprimtari e pavarur për krijimin e një databaze me njohuritë e reja.

Në këtë metodë u mundësua pjesëmarrja e të gjithë nxënësve dhe marrja e informacionit nga secili prej tyre. Nëpërmjet saj u identifikuan mangësitë e secilit/ës nxënësi/se.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh punën e pavarur, sepse ajo krijon një përfshirje të lartë në të nxënë, nxit krijimtarinë dhe mundëson reflektim për të nxënë.

Mësuesja: Valbona Xhabija valbona.xhabija@gea.edu.al